



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT VENDIM

**MBI PËRDORIMIN E FONDEVE TË KURSYERA NGA GRANTI I BAZUAR NË
PERFORMANCË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “MOBILIM I PARKUT NË
LAGJEN “ÇLIRIM” RAJONI NR. 1, BERAT”**

Këshilli Bashkiak Berat në mbledhjen e datës 23.07.2026 , pasi u njoh me materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Berat “Mbi përdorimin e fondeve të kursyera nga granti i bazuar në performancë për financimin e projektit “Mobilim i parkut në lagjen “Çlirim” Rajoni nr.1, Berat”, mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40, pika 1, neni 41, pika c, 54, gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 6, gërma “d”, neni 28, pika 5, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar , Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 14.01.2026 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 101 datë 22.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028”, i ndryshuar, Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 1031/5 datë 11.07.2025 dhe nr. 10725 datë 11.07.2025 “Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025”, Njoftimin e Ministrisë së Financave për shpalljen fituese të Bashkisë Berat me shkresën e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore nr. 764 datë prot. datë 19.12.2025, Detajimin e Fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025, me burim financimi nga buxheti i shtetit , me shkresë të Ministrisë së Financave nr. 18133/1 prot. datë 24.12.2025 e regjistruar në institucionin tonë nr. 7446 prot, datë 30.12.2025 , me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat, VKB nr. 22 datë 27.02.2026 ‘‘Mbi përdorimin e fondeve të grantit të bazuar në performancës për financimin e Projektit ‘‘Mobilim i Parkut tek Biblioteka’’,

V E N D O S I :

1. Të miratojë përdorimin e fondeve të kursyera në shumën **1,782,263 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë**, të krijuara nga procedura e prokurimit të projektit "Mobilim i Parkut tek Biblioteka", të financuar nga Granti i Bazuar në Performancë.
2. Fondi i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi të përdoret për financimin e projektit **"Mobilim i Parkut në lagjen “Çlirim”, Rajoni nr. 1, Berat"**.
3. Financimi do të realizohet nga fondet e Grantit të Bazuar në Performancë, me burim financimi të të brendshëm, në përputhje me Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

të Pushtetit Vendor nr. 1031/5 prot. dhe nr. 10725 prot., datë 11.07.2025 “Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025”,

4. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për ndjekjen e procedurave buxhetore dhe financiare, Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, dhe Drejtoria Juridike, për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe realizimin e procedurave të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Berat për dërgimin e këtij vendimi në Ministrinë e Financave, në kuadër të procedurave të Grantit të Bazuar në Performancë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Evisa ÇELA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKT VENDIM

**MBI MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESEM 2027-2029**

Këshilli Bashkiak Berat, në mbledhjen e datës ____/07/2026, pasi u njoh me materialin “Mbi miratimin e tavaneve përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029”, mbështetur në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 7 datë 27.02.2026 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2027-2029”, Udhëzimit Plotësues nr. 17 datë 10.07.2026 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029”, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 29 datë 30.03.2026 "Mbi miratimin e tavaneve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029" me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I :

1. Të miratojë Tavanet përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 sipas Tabelave bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij p/vendimi.

2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhimin Strategjik dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve Buxhetore.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Berat.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Evisa ÇELA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, datë _____ / _____ / 2026

MBI MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTIT “REHABILITIM I PJESSHËM I KANALIT USHYQES TË REZERVUARIT TË MBOLANIT” DHE MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR MBROJTJEN CIVILE VITI 2026, TË FINANCUAR NGA AGJENSIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE, NË SHUMËN 9,200,000.03 LEKË ME TVSH.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës _____ / _____ / 2026, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, VKM nr. 414 date 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, pika 3, paragrafi 3.1, gjerat e, gj, Ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”,

VENDOSI :

- 1.Miratimin në parim të Projektit “ Rehabilitim i pjesshëm i kanalit ushqyes të rezervuarit të Mbolanit”.
- 2.Miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile,të financuar nga Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në shumën prej 9,200,000.03 lekë me tvsh.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi: Drejoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve,Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Investimeve, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria Juridike.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

KRYETAR
I KËSHILLIT BASHKIAK
Evisa Çela



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, Datë / / 2026

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës / 07/2026, pasi u njoh me materialin mbi miratimin e projektit “SOILSTICE, Forcimi i Institucioneve dhe Lokaliteteve tona për Transformimin e Tokës, Përfshirja dhe Angazhimi Qytetar, HORIZON –MISS-2025-05”, në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8, nenit 9 pika 1, shkronja “a”, nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Marreveshjes së Agjencia Ekzekutive Evropiane e Kërkimit (REA), i cili përfaqëson Bashkimin Evropian, Republikës së Italisë dhe 'koordinatori': RESEAU EUROPEEN POUR DES INICIATIVES COMMUNAUTAIRES SUR LES CHANGEMENTS CLIMATIQUES ET LE DEVELOPPEMENT DURABLE (ECOLISE), Rregullorja (BE) 2021/625 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 28 Prill 2021 “Për krijimin e programit Horizon Europe”; Udhëzim nr. 10, datë 12.7.2024 për regjistrimin, perdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombetare).

VENDOSI :

1. Të miratojë Projektin “SOILSTICE, Forcimi i Institucioneve dhe Lokaliteteve tona për Transformimin e Tokës, Përfshirja dhe Angazhimi Qytetar, HORIZON –MISS-2025-05, Ref. Ares(2026) 5086035 - 19/05/2026”.

Ky projekt do të zgjasë 38 Muaj deri në 31 Tetor 2029, vlera totale e projektit për Bashkinë Berat është 5,131,500 Lekë nga të cilat 5,131,500 Lekë janë financim i Bashkimit Evropian . Bashkia Berat nuk do të bashkëfinancojë në këtë projekt.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Integritimit EU dhe Projekteve, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, dhe Drejtoria Juridike.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

KRYETAR
I KËSHILLIT BASHKIAK
Evisa Cela



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2026

MBI MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA NË FAVOR TË SHOQËRISË SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V TË PASURIVE NË PRONËSI TË BASHKISË BERAT

Mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” Neni 9 pika 1.2 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” nënpika “a” dhe “c”, Neni 27 pika 1,2,5, Neni 54 pika ‘e’ dhe Neni 55 pika 4 si dhe ligjit 9693/2007 “Për fondin kullor” të ndryshuar dhe VKM nr 433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish - Komunave/Bashkive, pika 4 si dhe të VKM Nr 1064 datë 22.12.2020 “Për disa ndryshime në VKM Nr 391 datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” Shtojca 9”, VKM Nr 54 datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” Kreu III pika 2. si dhe VKM nr 834 datë 21.11.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Berat, të Qarkut të Beratit” si dhe Ligjit Nr.24 datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujëtjes dhe kullimit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë dhënien me qira në favor të Shoqërisë Shell Upstream Shqipëri B.V të katër pasuritë të llojit kullotë, në pronësi dhe/ose përdorim të Bashkisë Berat, sipas listës bashkëlidhur projekt-vendimit.
2. Qiraja do të realizohet për të katër pasuritë, për një periudhë 1 (një vjeçare) me të drejtë rinovimi.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Mjedisit

KRYETARI I KËSHILLIT

Evisa ÇELA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2026

MBI MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË PASURISË ME NR.14/337, ZONA KADASTRALE 8502, ME SIPËRFAQJE TOTALE 1443.5 M² NGA TË CILAT 1443.5 M² TRUALL DHE 751 M² NDËRTESEË NGA BASHKIA BERAT TE KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR (KLGJ) PËR NDËRTIMIN E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM BERAT.

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 9, pika 1.1 , neni 24, neni 54, neni 64 gërma “c”; ligjin nr.115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e transferimit të pasurisë me nr.14/337, zona kadastrale 8502, me sipërfaqje totale 1443.5 m² nga të cilat 1443.5 m² truall dhe 751 m² ndërtesë, për ndërtimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, nga Bashkia Berat në pronësi të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ).
2. Fitimin e pronësisë të objektit ekzistues i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat nga Ministria e Drejtësisë të Bashkia Berat, me numër pasurie nr.5/124, zona kadastrale 8503, në rast të transferimit të pasurisë me nr.14/337, zona kadastrale 8502, nga Bashkia Berat te Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ).
- 3.Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Mjedisit.

KRYETARI I KËSHILLIT

Evisa ÇELA